

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 46, datë 09.06.2004

PËR
“POLITIKËN E PËRDORIMIT TË INTERNETIT DHE E-MAIL”

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës, në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Të miratojë materialin “Politika e përdorimit të internetit dhe e-mail”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat e Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Vendimi nr. 87, datë 27.11.2002 “Për miratimin e udhëzimit “Politika e përdorimit të internetit” shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli MEMISHA

KRYETARI
Shkëlqim CANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.46, datë 09.06. 2004

Të përgjithshme

Ky dokument përmban politikën e Bankës së Shqipërisë (Banka) për përdorimin e internetit si dhe të mjeteve të tjera të teknologjisë së informacionit (TI) që e shoqërojnë atë. Kjo politikë është e detyrueshme për të gjithë punonjësit e Bankës së Shqipërisë dhe për çdo person të jashtëm (kontraktor, konsulent, nëpunës të përkohshëm, personeli i shitjeve etj.), i cili mund të aksesojë sistemet dhe infrastrukturën e teknologjisë së informacionit të Bankës.

Interneti është një mjet i fuqishëm dhe i dobishëm për gjetjen dhe për shkëmbimin e informacioneve të dobishme për aktivitetin e Bankës. Përdorimi i tij me korrektësi dhe në përputhje me praktikën më të mirë, mund të përmirësojë prodhimtarinë dhe të lehtësojë punët e përbashkëta ndërmjet Bankës dhe partnerëve të saj në biznes siç janë: komuniteti bankar, institucionet qendrore qeveritare, institucionet ndërkombëtare, si dhe klientët e publikun.

Sidoqoftë, interneti paraqet mjaft rreziqe, të cilat mund të jenë me karakter teknik ose biznesi. Për shembull, nëpërmjet tij është e mundur të futen programe të paautorizuara (që quhen "malware"), të cilat mund të hyjnë nëpërmjet e-mail ose nëpërmjet faqeve të internetit (Web browser) dhe të shkatërrojnë, të korrumpojnë ose të dekonspirojnë të dhëna të rëndësishme për zhvillimin e aktivitetit të Bankës. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptohet se informacioni që transmetohet me anë të e-mail mund të shpërndahet edhe në persona të tjerë të ndryshëm nga marrësi origjinal, duke i shkaktuar Bankës, ndoshta edhe shtetit Shqiptar, lëndime dhe konflikte zyrtare .

Objektivi i kësaj politike të përdorimit të internetit është disiplinimi i përdorimit të internetit në Bankë (nëpërmjet vendosjes së rregullave dhe të procedurave të nevojshme) për të minimizuar pasojat e mundshme të pafavorshme dhe për të siguruar që i gjithë personeli të ketë mundësi të përfitojë maksimalisht përparësitë që ofron përdorimi i internetit, duke qenë të mbrojtur e të sigurt. Gjithashtu, kjo politikë është në përputhje me politikën dhe me rregullat e tjera të Bankës së Shqipërisë që kanë të bëjnë me përdorimin e teknologjisë së informacionit në përgjithësi.

Politika të përgjithshme dhe standardet e sjelljes

- Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe materiale të tjera të krijuara, të ruajtura dhe/ose të transmetuara me sistemet dhe me infrastrukturën e Bankës janë

pronë e Bankës. Çdo informacion i tillë mund të rishikohet ose të aksesohet nga drejtuesit e Teknologjisë së Informacionit ose nga drejtuesit përkatës të nëpunësit, në përputhje me procedurat e miratuara për këtë qëllim.

- Çdo disketë ose disk (CD, ZIP, Type, Hard Disk etj.) që vjen nga jashtë ndalohet të futet në pajisjet e rrjetit të Bankës: (I) pa marrë më parë lejen nga Teknologjisë së Informacionit dhe (ii) pa bërë më parë kontrollin (scanning) e tij për viruse duke përdorur programe të posaçme të Bankës për këtë qëllim.
- Çdo software, i çfarëdo lloji tipi apo burimi qoftë, ndalohet të instalohet në ndonjë kompjuter, server apo pajisje tjetër të rrjetit kompjuterik të Bankës pa marrë më parë lejen e Teknologjisë së Informacionit .
- Çdo skedar (file) i ekzekutueshëm ose media (si, *.exe, *.com, *.avi etj.) ndalohet të ekzekutohet ose të instalohet nëpërmjet e-mail, internetit ose ndonjë mënyre tjetër pa marrë paraprakisht lejen e Teknologjisë së Informacionit .

Përdorimi i lejuar i Teknologjisë së Informacionit

Mjetet e Teknologjisë së Informacionit të Bankës kanë për qëllim mundësimin apo lehtësimin e punonjësve të saj në:

- kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësive të caktuara;
- mbështjen e aktiviteteve zyrtare të Bankës;
- aksesimin e informacioneve që kanë lidhje me detyrat dhe me funksionet e tyre;
- komunikimin dhe bashkëpunimin me kolegë dhe me persona të jashtëm për realizimin e detyrave të ngarkuara;
- (Me miratimin me shkrim të drejtuesit të tyre.) zhvillimin e shprehive dhe të aftësive që lidhen me punën si dhe për të aksesuar informacionet që kontribuojnë në rritjen e performancës në punë të punonjësit dhe/ose në zhvillimin e tij profesional;
- zbatimin me përpikmëri dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me të gjitha procedurat e sigurisë dhe të mbrojtjes;
- zbatimin me përpikmëri të rregullave, të politikave dhe të standardeve të sjelljes të Bankës.

Të gjitha informacionet që ndodhen në sistemet dhe në infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit të Bankës, në çdo kohë, mbeten pronë e saj.

Kufizimet në përdorimin e e-mail-it dhe e internetit.

Të gjithë punonjësit dhe përdoruesit e autorizuar të Teknologjisë së Informacionit të Bankës të kenë parasysh se shërbimet e e-mail dhe të internetit ofrohen me të vetmin qëllim - mbështetjen e veprimtarisë së Bankës. Asnjë punonjës ose person tjetër që ka të drejtë të aksesojë sistemet dhe infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit të Bankës, nuk mund t'i përdorë ato për:

- të vizituar faqet e internetit, të cilat përmbajnë materiale që kanë të bëjnë me dhunën, me kërcënimet, me ngacmimet raciale apo seksuale ose që janë në kundërshtim me standardet apo me normat e Bankës;
- të dërguar çfarëdo e-mail nisur për qëllime personale ose që kanë lidhje me biznesin personal;
- të kryer aktivitete të jashtëligjshme ose veprimtari të tjera keqdashëse;
- të shfaqur në ekran ose për të shtypur në letër materiale ose figura, të cilat kanë përmbajtje seksuale, diskriminuese ose që kanë për synim shqetësimin e ndonjë personi tjetër;
- të nisur mesazhe publike apo private që përmbajnë fjalë ofenduese (fyese);
- lodra kompjuterike, me përjashtim të rasteve kur ato përdoren si mjete trainimi;
- komunikimin direkt nëpërmjet “chat”;
- keqprezantimin e Bankës ose të dikujt tjetër;
- aktivitete që mund të shkaktojnë mbingarkesë dhe dëmtim të rrjetit dhe të sistemeve, siç është dërgimi ose ridërgimi (pasimi) i e-mail zinxhir;
- nxjerrjen (transmetimin) e informacioneve në kundërshtim me rregulloren dhe me procedurat e ruajtjes së sekretit.

Administrimi i trafikut

Aksesimi në internet për Bankën është i kufizuar¹. Në këto kushte Banka, nëpërmjet drejtuesve të Teknologjisë së Informacionit dhe drejtuesve përkatës të përdoruesve të saj, realizon administrimin e trafikut në internet me qëllim përdorimin optimal të shërbimit, nëpërmjet vendosjes së përparësive në shërbimet (komunikimet) që lidhen direkt me aktivitetet zyrtare. Banka administron dhe monitoron të gjithë trafikun e informacionit nëpërmjet:

- ndjekjes së aktivitetit ditor të shërbimeve, problematikave ditore dhe vendosjes së prioriteteve ose të kufizimeve mbi secilin prej tyre;
- ndjekjes së aktivitet ditor të përdoruesve duke implementuar prioritete ose kufizime që përpunohen me pozicionin dhe me detyrat funksionale të secilit prej tyre;
- ndjekjes së ngarkesës së rrjetit dhe vendosjes së kufizimeve për të eliminuar mbingarkesat që mund të shkaktohen në të.

Lidhja në internet

Ndalohet lidhja e kompjuterave të Bankës në internet:

- deri sa nuk ka lindur nevojë e bazuar në aktivitetin e Bankës, e cila duhet të miratohet dhe të dokumentohet nga drejtuesi përkatës dhe drejtuesi i Teknologjisë së Informacionit;
- kur kompjuteri përdoret për të aksesuar të dhëna sensitive të Bankës. Kjo, në mënyrë të veçantë, zbatohet për kompjuterat që punojnë me aplikacione dhe

¹ Trafiku maksimal i gjeneruar në njësinë e kohës (bandwidth) është i kufizuar.

të dhëna kritike si për shembull, sistemi kontabël dhe për administrimin e thesarit, sistemi SWIFT etj., që janë pjesë kritike e aktivitetit të Bankës.

- Në rastet kur është e domosdoshme, për të mbështetur punonjësit që kanë kufizime, për aksesimin e internetit vendosen kompjutera të veçuar nga aplikimet dhe kjo gjë kryhet vetëm me kërkesën e personave të autorizuar, dhe me miratimin me shkrim të drejtuesit përkatës dhe të drejtuesit të Teknologjisë së Informacionit .

Monitorimi i përdorimit të internetit

I gjithë personeli duhet të jetë i vetëdijshëm që, sa herë që aksesohet një faqe interneti, një sasi e konsiderueshme informacioni regjistrohet, si në vetë faqen e internetit ashtu edhe në kompjuterat personalë dhe në kompjuterat e në pajisjet qendrore të Bankës që kontrollojnë rrjetin. Në këto informacione mund të përmbahen:

- në faqen Internet, “emri” i kompjuterit që po përdoret, përfshi këtu emrin e DOMAIN-it të Bankës (kjo është adresa në internet e Bankës). Gjithashtu, në disa raste, mund të regjistrohet adresa e e-mail ose emri me të cilin logohet përdoruesi në rrjet;
- në kompjuterin lokal, adresa e faqes internet që vizitohet. Gjithashtu, duke vizituar një faqe interneti, regjistrohen tekste dhe figura në një vend të rezervuar (cache) të diskut lokal të kompjuterit. Deri sa këta të mbishkruhen nga dokumente dhe skedare të tjera, këto të dhëna mund të ripërtërihen (recovered);
- gjithashtu, në kompjuterin lokal ruhen sasi të vogla të dhënash të quajtura “cookies”. Këto “cookies” përmbajnë informacion për faqet që janë vizituar në internet;
- kompjuterat apo pajisjet qendrore që kontrollojnë dhe administrojnë rrjetin e Bankës, për arsye sigurie, monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme trafikun që kalon si për brenda ashtu dhe për jashtë Bankës. Kështu, drejtuesit e Teknologjisë së Informacionit dhe personeli teknik kanë mundësi të ekzaminonjë çdo të dhënë që ka të bëjë si me e-mail ashtu edhe me faqet e internetit që shihen nga përdoruesit.

Përdorimi i e-mail

Punonjësit e Bankës ndalohen të përdorin e-mail për komunikime personale .

Ndalohet shfrytëzimi i e-mail për veprimtaritë e mëposhtme (por nuk kufizohet vetëm në to):

- veprimtari adventureske tregtare, fetare ose politike, jashtë aktivitetit të Bankës ose që nuk lidhen me punën direkte të punonjësit;
- dërgim materialesh poshtëruese/përçmuese për Bankën ose për ndonjë organizatë ose person tjetër;

- dërgim materialesh që përmbajnë shpifje, të dhëna të pasakta, abuzive, të pahijshme, përdhosëse, me orientim seksual, kërcënues, sulme raciale ose gjëra të tjera të jashtëligjshme;
- propagandim/shpërndarje e e-mail zinxhir;
- dërgim materialesh që përbëjnë shkelje të të drejtës së personit për ruajtjen e fshehtësisë;
- përdorimin e privilegjeve speciale për të parë, për të ndryshuar, për të bërë të njohur ose për të shpërndarë informacione të një përdoruesi tjetër, pa patur më parë autorizimin e nevojshëm për të bërë një gjë të tillë.

Nivelet e aksesimit të internetit dhe të komunikimit me e-mail

- Aksesimi i internetit si dhe komunikimi i jashtëm me e-mail, do të realizohet sipas niveleve. Të gjithë përdoruesit e internetit dhe të e-mail do të ndahen në nivele përdorimi, në bazë të nevojave për aksesimin e tij. Klasifikimi i punonjësve në këto nivele, kryhet në përputhje me pozicionin, me detyrat si dhe mbështetur mbi nevojat konkrete të argumentuara nga drejtuesit e njësive.
- Ndryshimi midis niveleve lidhet me numrin e kufizimeve të vendosura në secilin prej tyre. Punonjësit e niveleve të ulëta do të jenë më të kufizuar në aksesimin e internetit apo këmbimet e e-mail, ndërsa si rregull niveli më i ulët do të lejohet të komunikojë apo të aksesojë vetëm institucione, të cilat kanë lidhje të vazhdueshme me Bankën (për shembull banka apo institucione qendrore, banka të nivelit të dytë, institucione kërkimi etj.).

Të fundit

- Për zbatimin e kësaj politike, autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të nxjerrë udhëzime të veçanta.
- Kjo politikë hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës
Shkëlqim CANI**

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. “Për miratimin e bilancit dhe për

përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.

6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.
2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004. Për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës”.
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004. “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004. Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004. Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Mars 2004

1. Vendim nr. 26, datë 14. 04. 2004. Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve
2. Vendim nr. 27 datë 14. 04. 2004. “Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004

1. Vendim nr. 28, datë 28 04. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.
2. Vendim nr. 29, datë 28 04. 2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore”
3. Vendim nr. 30, datë 28. 04. 2004. Për dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.
4. Vendim nr. 31, datë .28 04. 2004. Për “Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004

1. Vendim nr. 35, datë 12 05. 2004. Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004

1. Vendim nr. 36, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e Raportit “Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr. 37, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.
3. Vendim nr. 38, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores “Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”.
4. Vendim nr. 39, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”.